

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

UNMIK/REG/2005/2
21 janar 2005

RREGULLORE NR. 2005/2

**PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT TË PAVARUR MBI MINIERAT DHE
MINERALET NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 qershor 1999 mbi Autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në përputhje me nenin 8.1 (q) dhe (r) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001) dhe pas konsultimit me anëtarët e Këshillit ekonomik dhe fiskal dhe me Qeverinë,

Duke i marrë parasysh përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit,

Me qëllim të themelimit të Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Minerale si organ i pavarur rregullator, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e industrisë së minierave në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1

Komisioni i pavarur për minierat dhe mineralet

1.1 Themelohet Komisioni i pavarur për minierat dhe mineralet (më tej "Komisioni") si organ i pavarur në pajtim me nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese, me seli në Prishtinë.

1.2 Komisioni përbëhet nga Bordi drejtues (“Bordi”), i cili i ka pesë anëtarë duke përfshirë kryesuesin, drejtorin e minierave (“drejtori”), zëvendësin e drejtorit të minierave (“zëvendësdrejtorin”) si dhe personelin tjetër profesional dhe nëpunësit, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

Neni 2 Kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit

2.1 Komisioni rregullon dhe i mbikëqyrë:

(a) Eksplorimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë në pajtim me ligjin në fuqi;

(b) Shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimet e shfrytëzimit të minierave dhe zvogëlimin e ndikimit të veprimeve të shfrytëzimit të minierave në mjedis;

(c) Zbatimin e standardeve ndërkombëtare për veprimet në miniera dhe në gurore;

(d) Sigurinë gjatë veprimeve të nxjerrjes së mineraleve dhe në objektet e përpunimit në pajtim me ligjin në fuqi dhe me standardet e nevojshme për sigurinë dhe

(e) Pajtueshmërinë e përgjithshme të veprimeve për shfrytëzimin e minierave me kushtet e licencave, marrëveshjeve për leje dhe të instrumenteve të tjera për autorizim.

2.2 Komisioni, në pajtim me ligjin në fuqi, është përgjegjës për kryerjen e funksioneve vijuese:

(a) Lëshimin, bartjen, pezullimin dhe tërheqjen e lejeve dhe të licencave për eksplorim dhe shfrytëzim;

(b) Lëshimin, bartjen, pezullimin dhe tërheqjen e lejeve dhe të licencave lidhur me shfrytëzimin e lëndëve plasëse në veprimet për shfrytëzimin e minierave;

(c) Kryerjen e hetimeve lidhur me aksidentet që ndodhin në miniera dhe në gurore dhe veprimet e domosdoshme që nevojiten si pasojë e kësaj;

(d) Krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për titullarët e mineraleve dhe të drejtave për shfrytëzimin e minierave dhe

(e) Ofrimin e ndihmës teknike Qeverisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë.

2.3 Komisioni i dorëzon raporte të rregullta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (“PSSP”) përmes zëvendësit të PSSP-së për rindërtim ekonomik lidhur me të gjitha aktivitetet e komisionit, duke përfshirë edhe çështjet e personelit të tij, organizimin dhe çështjet administrative.

Neni 3 Bordi drejtues

3.1 Të gjitha kompetencat e komisionit i jepen bordit. Bordi mund t’i delegojë funksione të caktuara drejtorit përveç atyre që i janë dhënë në pajtim me këtë Rregullore.

3.2 Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga shpallja e kësaj Rregulloreje, anëtarët e bordit emërohen si vijon:

(a) Tre (3) anëtarë, duke përfshirë edhe kryesuesin, i emëron PSSP-ja me rekomandim të zëvendësit të PSSP-së për rindërtim ekonomik;

(b) Dy (2) anëtarë emërohen nga PSSP-ja me rekomandim të Qeverisë dhe pas miratimit nga Kuvendi.

3.3 Anëtarët e parë të bordit emërohen për periudhën vijuese:

(a) Dy (2) vjet për kryesuesin dhe një për njërin nga anëtarët e tjerë të emëruar në pajtim me nenin 3.2.a;

(b) Tri (3) vjet për anëtarin tjetër të emëruar në pajtim me nenin 3.2.a dhe

(c) Katër (4) vjet për dy anëtarët e emëruar në pajtim me nenin 3.2.b.

3.4 Anëtarët pasues të bordit emërohen për periudhën prej katër (4) vitesh, me mundësi të riemërimit.

3.5 Bordi do të fillojë të funksionojë dhe të ushtrojë pushtetin e tij sapo të jenë emëruar së paku tre (3) anëtarë, ashtu siç parashihet në nenin 3.2 ose pas nëntëdhjetë (90) ditëve nga shpallja e kësaj Rregulloreje, varësisht se cila ndodh më vonë. Derisa bordi të jetë në gjendje të kryejë funksionin dhe ta ushtrojë pushtetin e tij, drejtori i kryen funksionet e tilla dhe e ushtron pushtetin e tillë.

3.6 Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet anëtar i bordit nëse personi i tillë:

(a) Ka qenë i dënuar, pas procesit të rregullt, në pajtim me standardet ndërkombëtare me një apo më shumë vjet burgim;

(b) Ka qenë i përjashtuar ose i suspenduar për sjellje të keqe profesionale nga ushtruarimi i profesionit të tij, pas procesit të rregullt, në pajtim me standardet ndërkombëtare;

(c) Ka ose siguron interes të drejtpërdrejtë a të tërthortë në ndonjë organizatë tregtare, e cila në aspektin komercial është e angazhuar në sektorin e minierave ose

(d) Ka interesa që janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 2 të kësaj Rregulloreje.

3.7 Nga anëtarët e bordit kërkohet që të kenë diplomë valide të universitetit dhe të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë në punë profesionale të dëshmuar në miniera, inxhinieri, gjeologji, ekonomi të tregut, në menaxhment, në kontabilitet ose në drejtësi. Së paku dy (2) anëtarë të bordit duhet të kenë përvojë të konsiderueshme në miniera.

Neni 4 Organizimi i bordit dhe votimi

4.1 Kryesuesi e përfaqëson bordin publikisht, e menaxhon dhe e organizon punën e bordit.

4.2 Mbledhjet e bordit thirren nga kryesuesi për çdo muaj ose në rastet kur këtë e kërkojnë dy anëtarë të tjerë të bordit apo drejtori.

4.3 Bordi i merr vendimet me konsensus dhe kur nuk arrihet konsensus, atëherë me shumicën e thjeshtë të votave pozitive të anëtarëve të bordit të cilët janë të pranishëm. Bordi ka kuorum të marrë vendim nëse tre (3) anëtarë janë të pranishëm gjatë tërë mbledhjes në të cilën merret vendimi ose, në rastin kur vendimi merret jashtë mbledhjes, nëse tre (3) nga të gjithë anëtarët të cilët duhet të vendosin e vërtetojnë vendimin me shkrim.

4.4 Kryesuesi i kryeson mbledhjet e bordit. Kur është e nevojshme që bordi të takohet në mungesë të kryesuesit, kryesuesi e autorizon një anëtar tjetër të bordit që ta kryesojë mbledhjen.

4.5 Bordi mund të vendosë rregulla plotësuese procedurale për t'i drejtuar veprimet e tij, të cilat publikohen dhe i ofrohen secilit person që e kërkon një kopje të rregullave të tilla.

4.6 Personeli i komisionit i ofron bordit shërbime ndihmëse të sekretarisë.

Neni 5 Drejtori

5.1 Drejtori dhe zëvendësdrejtori emërohen nga PSSP-ja me rekomandim të Zëvendësit të PSSP-së për rindërtim ekonomik. Nenet 3.6 dhe 3.7 të kësaj Rregulloreje zbatohen për drejtorin dhe zëvendësdrejtorin në përputhje me rrethanat.

5.2 Drejtori është kryeshf ekzekutiv i komisionit dhe është përgjegjës për:

(a) Kryerjen e të gjitha funksioneve me të cilat e ngarkon bordi;

(b) Udhëheqjen e punës së zakonshme të komisionit në pajtim me vendimet ose udhëzimet e nxjerra nga bordi;

(c) Organizimin, emërimin dhe shkarkimin e personelit (përveç zëvendësdrejtorit) të komisionit në pajtim me vendimin që e merr bordi apo udhëzimin që e nxjerr;

(d) Përgatitjen e mbledhjeve të bordit dhe sigurimin e zbatimit të duhur të vendimeve të marra nga bordi.

5.3 Drejtori mund të marrë pjesë në mbledhjet e bordit, por nuk ka të drejtë vote.

5.4 Zëvendësdrejtori i kryen funksionet e drejtorit në rastet kur drejtori nuk mund t'i kryejë detyrat e tij.

Neni 6 Detyrimet

6.1 Kërkesat për dëmshpërblim të shkaktuara nga mbajtësi i licencës mund t'i drejtohen komisionit vetëm nëse kërkesat e tilla nuk kanë mundur të zgjidhen nga mbajtësi i licencës në fjalë, duke përfshirë edhe kompaninë e tij të sigurimit dhe nëse pala e dëmtuar mund të vërtetojë se komisioni së paku pjesërisht e ka shkaktuar dëmin duke vepruar qëllimisht apo me pakujdesi të plotë, në kundërshtim me praktikat më të mira administrative.

6.2 Drejtori, personeli profesional dhe administrativ i komisionit nuk i japin llogari askujt tjetër përveç komisionit për ndonjë mosveprim apo veprim të ndërmarrë në emër të komisionit dhe në kuadër të fushës së autorizimit që i është dhënë drejtorit, personelit profesional ose atij administrativ me anë të kësaj Rregulloreje.

Neni 7 Përgjegjësia

7.1 I tërë bordi dhe drejtori i përgjigjen në çdo kohë PSSP-së për pajtueshmërinë e komisionit me:

(a) Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;

(b) Dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe të cilësdo rregulloreje, urdhërese administrative, udhëzimi a vendimi tjetër administrativ të cilat mund t'i nxjerrë PSSP-ja lidhur me këtë Rregullore dhe

(c) Çdo ligji tjetër në fuqi në Kosovë.

7.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në çdo kohë mund të:

(a) Anulojë ose modifikojë ndonjë vendim të komisionit nëse ai konstaton se vendimi i tillë nuk është në pajtim me nenin 6.1 dhe

(b) Urdhërojë ndonjë veprim të komisionit të cilin ai e konsideron të domosdoshëm për të qenë në pajtim me nenin 6.1.

Neni 8 Dispozitat financiare

8.1 Komisioni i përcakton shpenzimet e tij operacionale dhe të hyrat e përafërta në formë të planit buxhetor një vit përpara dhe këtë ia dërgon me kohë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për t'u miratuar dhe rishikuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Plani buxhetor i komisionit shfrytëzohet nga Ministria për Ekonomi dhe Financa në procesin buxhetor dhe mund të përditësohet rregullisht nga komisioni, në pajtim me kërkesat buxhetore.

8.2 Të hyrat që rrjedhin nga qiraja për shfrytëzimin e nëntokës, nga pagesat për licencë dhe nga pagesat tjera që mblidhen në pajtim me këtë Rregullore dhe me rregulloret, urdhëresat administrative ose instrumentet tjera legislative pasuese depozitohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe shfrytëzohen për qëllime të autorizuara sipas kategorisë përkatëse buxhetore dhe në pajtim me procesin buxhetor.

8.3 Fondet e caktuara nga donatorët dedikuar komisionit derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, regjistrohen si të tilla në të dhënat e kontabilitetit të thesarit dhe konsiderohen si shpenzime të lejuara për qëllimet e komisionit.

Neni 9 Zbatimi

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje PSSP-ja mund të nxjerrë urdhëresa administrative.

Neni 10 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në pajtim me të.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 21 janar 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm